

**FTESE PER OFERTE**

I/E nderuar Zoteri/Zonje,

1. Ju jeni te lutur te paraqitni oferten tuaj per **“Punime Elektrike dhe Civile ne zyrat e reja te Tirana Bank tek godina MET Building (katet -1, +1, +2, +5)”**  
*Per informacion me te detajuar ju lutem shikoni piken 5 (Detajet) dhe **Aneksin A** bashkengjitur.*
2. Ju mund te jepni oferten Tuaj per sherbimin e lartpermendur, per te cilat do te kete procedure vleresimi dhe do te lidhet kontrate me ofertuesin/ofertuesit me te mire. {Ju mund te paraqisni oferten tuaj duke u bazuar ne FTESEN PER OFERTE}.
3. Oferta Juaj duhet te dergohet ne zarf te mbyllur. Siper zarfit duhet te shenoni emrin e kompanise dhe titullin e tenderit ne te cilin do merrni pjese, dhe ta dergoni ne adresen:  
**Njesia e Prokurimit**  
*Tirana Bank, Zyrat Qendrore*  
*Rr. "Ibrahim Rugova", Kutia Postare 2400/1.*  
*Tirane*
4. **Afati i fundit i pranimit te ofertave** eshte:  
**03.04.2025**
5. **Detajet:**
  - **Ky tender perfshin realizimin e punimeve Punime Elektrike dhe Civile ne Zyrat Qendrore te Tirana Bank**, per nje periudhe 2 vite me te drejte rinovimi dhe nje vit tjeter nese “Banka” nuk kerkon me shkrim perfundimin e kontrates 30 (tridhjete) dite perpara perfundimit te afatit..
  - **Projekti fillestar eshte per :**
    - Zyrat e reja qendrore te Tirana Bank tek godina MET Building, katet -1, +1, +2, +5.
  - **Ky tender ka punime si:**
    - Mure gipsi per ndarjet e brendshme t=10&15 cm tip T1&T2 te harkuar per ndarjet e brendeshme t=15 cm tip T3 sipas VT
    - Tavan i varur me gips te thjeshte T1
    - Veshje me panel multistrad e mureve te hakuar
    - Dyer filomuro D3&D7 me permasa 220x98 & 220x100 cm MDF D4&D5&D6 permasa 220x78 & 220x88 cm
    - Panel elektrik sipas Skemes se projektit KTB Kati 1&2&5
    - Prize shuko 16 A te kuqe
    - Kanaline metalike tip grile 200x75 & 150x75 mm e kompletuar me te gjitha aksesoret e montimit si suportet per tu mbeshetur etj
    - Tub fleksibel Ø=20&25 mm seria e rende i kompletuar me te gjitha aksesoret per fiksime ne tavan dhe ne faqe gipsi, si fasheta, grapeta vida upa fi 6mm
    - Kabell FROR 3x2.5 mm<sup>2</sup>
    - Kutitane kanaline metalike 100x100 e kompletuar me te gjitha aksesoret e montimit si vida upa etje
    - Torrete 6,12,24 Module
    - Rack 6U 60x45 & 28U 80x60 & 48U 80x100 Cm perfshire terminimin e kablove ne patch panele, testim kolaudim.
    - Patch panel FTP Cat 6, 24, 48 porta duke perfshire dhe terminimin dhe emertimin kabujve FTP Cat 6



- Switch i manaxhuesheshem me 48 porta RJ-45
- F.V. Bateri ventilatoresh te kopletuar me te gjithë aksesoret si permostat, kontrollor temperature etj
- Kabell FTP Cat 6
- Priza FTP CAT 6 RJ 45

Ne menyre te detajuar punimet jepen ne:

- a. Aneksin A ne lidhje me zerat kryesore te punimeve dhe kuotimi financiar
- b. Dhe ne Linkun: <https://we.tl/t-giSSAUyfCx>

➤ **Vlera e depozites per garancine e punimeve:**

- Kompanise fituese do t'i mbahet nje garanci depozite prane Tirana Bank per **12 (dymbedhete) muaj** pas perfundimit te sherbimit. Garancia e depozites arrin ne 15% te vleres totale te kontrates. Depozita do te lirohet ne fund te vitit, duke filluar nga perfundimi i kontrates me konfirmimin e Ekipit Teknik te Tirana Bank per cilesine e punimeve.
- Pas vleresimit te ofertave, afateve qe do te ofroni per realizimin e punimeve, duke marre ne konsiderate qe koha e implementimit eshte shume e rendesishme per Banken, mund te vleresohet dhe opsioni i ndarjes se punimeve ne 2 kompani te ndryshme (vec konstruktivet nga punimet elektrike/rrjeti data).

## 6. Kosto

Ju duhet te ofertoni per:

- **Cmim/njesi. Plotesoni Aneksin A.**
- **Oferta juaj financiare duhet te jete ekzaktesisht sipas specifikimeve teknike te tabelës ne Aneksin A.**
- **Ne kontrate cmimet per njesi te ofruara per projektin do jene ne fuqi gjate gjithë kohezgjatjes se kontrates.**
- **Ne cmim duhet te perfshihet TVSH dhe cdo takse dhe shpenzim tjetër.**

*Pershkrim i detajuar jepet ne aneksin A, ku duhen plotesuar dhe kostot qe ofroni.*

## 7. Afati i levrimit

- Procesi i realizimit te punimeve te projektit fillestar (blerje, prodhim dhe implementim) duhet te finalizohet brenda dates 30.04.2025. **Konfirmimin tuaj:** \_\_\_\_\_
- Nga ju duhet te dergohet skeduli i punimeve qe do te kryhen brenda dates 30.04.2025.

## 8. Garancia

- Garanci materialesh elektrike – Kerkuar nga Banka minimumi 1 vit. Ofruar nga ju \_\_\_\_\_
- Garanci punimesh elektrike – Kerkuar nga Banka minimumi 1 vit. Ofruar nga ju \_\_\_\_\_

## 9. Oferta Juaj duhet te shoqerohet nga dokumentet e me poshtme:

### A. Dokumentacion teknik dhe ligjor:

- Fotokopje e certifikates se regjistrimit si person i tatueshem nga organi perkates.
- Kopje e ekstraktit te printuar te Regjistrimit tregtar nga QKR brenda muajit te fundit.
- CV e kompanise ku te theksohet eksperienca e kompanise, klientet. Organograma e kompanise, si edhe organizimi per kete projekt/kontrate.
- Numri i stafit dhe profesionet perkatese te projektit te kerkuar nga Banka.
- CV-ja e stafit te projektit.
- Kompania duhet te kete ne staf ose me kontrate patjeter 1 (nje) Inxhinier Elektrik. CV e inxhinjerit te punesuar ose me kontrate.
- Leter Reference per bashkepunim relevant me institucione/kompani private.
- Certifikatat:
  - Certifikate ISO 9001:2015 "Sistemet e menaxhimit te cilesise",
  - Certifikate ISO 14001:2015. "Sistemi i Manaxhimit Mjedisor",
  - Certifikate ISO 45001:2018 certifikimi i sistemit per menaxhimin e sigurise/shendetit ne pune,



- Standartet e Materialeve Konstruktive/Elektrike Standart EN60598-1, Certifikatat duhet te jene te vlefshme dhe leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga RSH.
- B. Skeduli i punimeve te projektit, duke u perputhur me kohen e dorezimit te projektit
- C. **Formulari vigilences:** Plotesoni formatin bashkengjitur emalit.

## 10. Detajet e kontrates:

### **OBJEKTI**

Banka i ngarkon Sipermarresit, kryerjen e sherbimeve per punimeve ne ambientet e zyrave te reja qendrore te Tirana Bank, punime te cilat konsistojne ne **“Punime Elektrike dhe Civile ne zyrat e reja te Tirana Bank. Projekti fillestar do te jete tek godina MET Building (katet -1, +1, +2, +5) sipas Aneksit A bashkengjitur.**

Sipermarresi merr persiper kryerjen e ketyre punimeve kundrejt cmimeve, sic pershkruhet ne menyre analitike ne Aneksi A bashkengjitur kesaj kontrate.

Zbatimi i punimeve do te kryhet nen mbikeqyrjen e Departamentit te Menaxhimit te Aseteve dhe Sherbimeve te Pergjithshme te “Bankes”, i cili ne vijim do te quhet “Mbikeqyresi”, ne perputhje me Aneksin A, qe jane pjese e pandare e kesaj kontrate.

### **KOHEZGJATJA E KONTRATES**

Kontrata eshte e vlefshme per nje periudhe 2 vite me te drejte rinovimi dhe nje vit tjeter nese “Banka” nuk kerkon me shkrim perfundimin e kontrates 30 (tridhjetë) dite perpara perfundimit te afatit.

### **CMIMET DHE MENYRA E PAGESES**

Cmimet per realizimin e punimeve ne ambjentet e Zyrave Qendrore te Bankes do te jene sipas cmimeve te cilesuara ne Aneksin A bashkengjitur.

Ne kosto perfshihet TVSH dhe te gjitha taksat dhe tatimet e detyrueshme per t’u paguar sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Pagesa do te behet ne llogarine qe Sipermarresi ka ne Tirana Bank me numer llogarie ne LEKE: \_\_\_\_\_, brenda 30 diteve nga dorezimi i fatures te firmosur nga perfaqesuesi i Bankes, si dhe nga Sipermarresi. Ne rast se Banka nuk paguan brenda dites se duhur, Banka duhet t’i rimbursoje Sipermarresit, koston dhe shpenzimet qe do te rrjedhin nga mbledhja e shumave te papaguara ne afat.

Sipermarresi duhet te dorezoje se bashku me faturen dhe nje procesverbal me firmen e perfaqesuesit te Bankes per punen e kryer ne datat perkatese.

Sipermarresit do t’i mbahet nje garanci depozite prane Tirana Bank per nje periudhe prej **12 (dymbedhjetë) muaj** pas perfundimit te Punimeve. Garancia e depozites arrin ne 15% te vleres totale te kontrates. Depozita do te lirohet ne fund te vitit me konfirmimin e Ekipit Teknik te Bankes per cilesine e punimeve.

Cmimet do te mbeten te pandryshuar gjate gjithë kohezgjatjes se kontrates.

### **VENDOSJA NE OBJEKT – FILLIMI I PUNIMEVE - MBAJTJA E DITARIT**

Data e fillimit te punimeve dhe vendosjes se Sipermarresit ne objekt do te jete sipas njoftimit nga Mbikqyresi.

Mosfillimi ne afat i punimeve, per cdo lloj arsyeje pervec rasteve te forces madhore, i jep te drejten Bankes, qe nepermjet nje njoftimi me shkrim, te shpalle menjehere Sipermarresin “ne deshtim”, keshtu qe kjo kontrate zgjidhet pa asnje lloj detyrimi ose demshperblimi per cdo lloj arsyeje.

Sipermarresi eshte i detyruar te mbaje, rregullisht dhe ligjerisht, ditarin e punimeve, ku pershkruhen pervec te tjerave, ecuria e punimeve, punimet dhe materialet, si dhe instruksionet e Mbikeqyresit. Ditari i punimeve kontrollohet dhe nenshkruhet rregullisht (sipas pelqimit te Mbikqyresit) nga Mbikeqyresi.

### **GARANCITE**

Garancia e punimeve dhe materialeve si me poshte vijon:

- a) Garanci materialesh elektrike \_\_\_\_\_
- b) Garanci punimesh elektrike \_\_\_\_\_

Materialet qe do te perdoren nga Sipermarresi do te jene te reja, origjinale dhe sipas standarteve.

### **AFATET E ZBATIMIT TE PUNIMEVE - SANKSIONET LIGJORE**

Sipas kesaj kontrate, Procesi i realizimit te punimeve te projektit fillestar (blerje, prodhim dhe implementim)



duhet te finalizohet brenda dates 30.04.2025.

Sipermarresi eshte i detyruar qe:

- Brenda ketij afati te kete permbushur te gjithë detyrimet e tij kontraktore ne perputhje me Aneksin A bashkangjitur dhe punimet e kerkuara. Kuptohet qe, ndermjet afateve te mesiperme do te zbatohen te gjitha punimet e pretenduara, ne perputhje me kushtet teknike dhe shkencore te kerkuara.
- Sipermarresi verteton pasi ka marre parasysh te gjitha kushtet e punimeve si dhe kushtet specifikë te ketij objekti, se ka mundesine te zbatoje punimet qe ka marre persiper brenda afatit qe kane rene dakort.
- Sipermarresi ka te drejte t'i kerkoje Bankes zgjatjen e afateve ne rastet e meposhtme:
  - a. Ne rast se vertetohet qe per arsye te forcave madhore, u pengua ecuria normale e punimeve, e cila detyrimisht vertetohet nga ai vete.
  - b. Ne rast se gjate zbatimit te punimeve te dakortesuara, do te kete kerkese per ndryshime ne projekt nga Banka.
- Ne rastet e evenimenteve te mesiperme, Sipermarresi ka te drejte qe, brenda 24 oreve nga dita e ndodhjes se ngjarjes, te kerkoje shtyrjen e afateve, te cilen Banka nuk eshte e detyruar ta aprovoje ne rast se gjykon se ngjarjet nuk e justifikojne dhenien e aprovimit. Kerkesa me fuqi prapavepruese, per shtyrjen e afatit, nuk njihet.
- Per cdo dite vonese nga afati i dorezimit te pjesve te objektit ashtu sic kane rene dakort palet, Sipermarresi eshte i detyruar te paguaje si sanksion ligjor, nje shume te barabarte me 4/1000 te shumes totale te Preventit te pergjithshem, shume e cila do te kthehet ne rast se nuk shkelet afati perfundimtar i dorezimit te objektit. Shumat per sanksionet ligjore mund te mbahen nga cdo lloj shperblimi qe Banka i detyrohet Sipermarresit.
- Banka i mban vleren e gjobes Sipermarresit nga pagesa, duke dhene me shkrim arsyet dhe shumen e gjobes.
- Sipermarresi eshte i detyruar, qe te dorezoje nje grafik te detajuar te zhvillimit te punimeve te parashikuara. Ne perputhje me grafikun e detajuar kohor te zhvillimit te punimeve, behet kontrolli nga Mbikeqyresi mbi punimet.

#### **PAJISJET E SIPERMARRESIT**

Sipermarresi deklaron se disponon dhe do te vendose ne dispozicion, te gjithë pajisjet dhe mjetet e punes te domosdoshme per zbatimin e punimeve, pa pengese, ne afat dhe ne perputhje me kushtet dhe masat e sigurise. Sipermarresi nuk ka te drejte te largoje pajisjet nga vendi i punimeve, gjate gjithë periudhes se zbatimit te punimeve, vetem ne rastin kur pajisjet me leje me shkrim nga Mbikqyresit ose perfaqesuesit e tij.

Sipermarresi deklaron shprehimisht se eshte ne dijeni dhe pranon se, vlera dhe shpenzimet e qirase, te amortizimit, qofte kjo edhe e paparashikuar, si dhe cdo demtim tjeter i mundshem si dhe cdo shpenzim per transportin ose funksionimin e pajisjeve dhe te mjeteve te punes, jane parashikuar dhe perfshihen ne cmimet e ofertes se tij.

#### **PRANIA E SIPERMARRESIT NE OBJEKT. PERFAQESUESI I TIJ.**

Sipermarresi eshte i detyruar te jete personalisht i pranishem ne objekt, ose nepermjet nje perfaqesuesi te tij, inxhinier ose jo, i cili duhet te marre paraparakisht miratimin e Bankes dhe do te kujdeset per zbatimin e punimeve dhe mbikeqyrjen e personelit. Sipermarresi eshte i detyruar te njoftoje Banken, me shkrim, per perfaqesuesin e saj si edhe te marre miratimin e saj me shkrim per kete perfaqesues. Gjithashtu, Sipermarresi duhet t'i njoftoje Bankes dhe adresen e banimit te perfaqesuesit, sepse palet kane rane dakord qe ai eshte njekohesisht edhe perfaqesues ligjor i Sipermarresit.

Perfaqesuesi i Sipermarresit eshte i detyruar te jete i pranishem ne objekt gjate gjithë oreve te punes dhe gjate gjithë periudhes se zbatimit te punimeve qe Sipermarresi ka marre persiper. Shmangie mund te kete vetem me leje te Mbikeqyresit.

Palet merren vesh nepermjet kesaj kontrate, qe Perfaqesuesi i Sipermarresit te perfaqesoje Sipermarresin, plotesisht ne ceshtjet qe lidhen me zbatimin e punimeve por, ai nuk zevendeson Sipermarresin i cili eshte i detyruar te zgjidhe te gjithë mosmarreshet e mundshme qe mund te lindin gjate ecurise se punimeve. Ne pergjithesi, perfaqesuesi i Sipermarresit nuk angazhon me firmen e tij Sipermarresin (nuk merr persiper detyrime per llogari te Sipermarresit), pervec rasteve kur i eshte dhene me prokure te posacme e drejta per te pranuar shkresa nga Banka.

Banka ka te drejte te kerkoje ne cdo kohe zevendesimin e perfaqesuesit te caktuar, ne qofte se ai nuk kryen



detyrat e tij ne menyre te kenaqshme, Sipermarresi eshte i detyruar ta zevendesoje ate menjehere.

### **ORGANIZIMI I PUNES**

Sipermarresi eshte i detyruar te beje organizimin e punes ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe vecanerisht duhet te respektoje normat ligjore lidhur me ditet dhe oret e punes, sigurimet shoqerore e shendetesore, masat e sigurimit ne pune, etj.

### **MASAT E SIGURIMIT**

Sipermarresi eshte ekskluzivisht pergjegjes per sigurimin e mjeteve qe ka perdorur dhe punimeve te kryera dhe per rrjedhoje eshte ekskluzivisht pergjegjes per cdo lloj aksidenti, demi apo demtimi qe mund te pesoje ai vete apo te tretet, qe ka ardhur per faj te tij, nga neglizhenca ose mungesa e pervojes se tij ose e personelit te tij, gjate zbatimit te punimeve qe i jane dhene ose mund t'i jepen atij ne perputhje me kete kontrate, dhe ka pergjegjesi per cdo rast sipas dispozitave te ligjeve ne fuqi.

Ne qofte se Bankes i ngarkohet ndonje pergjegjesi atehere Sipermarresi eshte i detyruar ta demshperbleje ate plotesisht, per cdo dem te pesuar.

Gjithashtu, Banka te drejte qe, cdo shume qe ajo ka paguar ne menyre te vullnetshme per arsyet e mesiperme, ta mbaje nga cdo lloj shume qe Banka i detyrohet Sipermarresit ose edhe nga garancite qe Sipermarresi ka vene ne dispozicion te saj.

### **NJOHJA E KUSHTEVE TE PUNIMEVE**

Sipermarresi deklaron se ka vizituar objektin dhe ka krijuar mendimin e tij personal lidhur me hyrjet ne objekt, vendosjen dhe transportimin e materialeve dhe ne pergjithesi me te gjitha kushtet ligjore ose kushtet ndaluese qe mund te ndikojne ne zhvillimin normal te punimeve, koston e punimeve qe ka marre persiper te zbatoje, dhe se oferta e tij bazohet ne njohurite dhe gjykimin e tij personal lidhur me kushtet dhe rreziqet e objektit dhe rrjedhimisht nuk ka te drejte, ne asnje rast, qe te pretendoje asnje shperblim apo cdo lloj pagese shtese, per asnje arsye qe lidhet me kushtet e objektit.

Gjithashtu, Sipermarresi deklaron se eshte njohur plotesisht me te gjitha anekset e kesaj kontrate, me projektet, me pershkrimet e detajuara dhe karakteristikat e studimit, te cilin e konsideron te plote, te drejte dhe te zbatueshem, dhe ne rast te kundert ai do teinteresohej vete, per permiresimin dhe plotesimin e tyre pa demshperblim ne perputhje me studimet dhe me miratimin e Bankes dhe ne pergjithesi ta beje ate te zbatueshem dhe te pranueshem ne perputhje me rregullat teknike dhe legjislacionin ne fuqi.

Sipermarresi eshte i detyruar dhe premtan se do te veproje ne perputhje te plote me kushtet e lartpermendura dhe do te zbatoje punimet ne perputhje me preventivin e bere ose te korrigjuar, me urdherat dhe instruksionet e Mbikeqyresit dhe te vete Bankes, gjate gjithë periudhes se sipermarrrjes. Sipermarresi premtan se do te dorezoje ne Banke te gjithë projektet perfundimtare (as built) me te gjithë ndryshimet e materialeve, instalimeve, pajisjeve dhe makinerive te shoqeruara me projektin e detajuar teknik te makinerive dhe pajisjeve, instruksionet e perdorimit dhe te mirembajtjes ne Shqip si dhe cdo gje tjeter qe eshte e nevojshme per perdorimin dhe funksionimin e tyre nga personeli i Bankes.

### **PASTERTIA E VENDIT TE PUNES**

Gjate periudhes se punimeve, Sipermarresi eshte pergjegjes per mbajtjen paster te ambienteve ku kryhen punimet, si dhe per largimin ose shkaterrimin e pershtatshem te materialeve te padobishme, ne vendin dhe sipas menyres qe percaktohen nga Banka dhe autoritetet publike.

Pas perfundimit te punimeve qe ka marre persiper te kryeje, Sipermarresi eshte i detyruar te dorezoje ne gjendje plotesisht te paster si ambientet ku u kryen keto punime ashtu dhe ambientin publik.

Gjithashtu, ai eshte i detyruar te largoje nga vendi i punes pajisjet, makinerite dhe materialet e tjera te tij, si edhe cdo mbetje apo mbeturine qe ka mbetur nga punimet e kryera.

Ne rast se Sipermarresi nuk respekton detyrimet e ketij neni, Banka ka te drejte qe me mbarimin e nje afati 5 (pese) ditor nga njoftimi i saj paraprak, te beje pastrimin e ambienteve per llogari te Sipermarresit duke mbajtur keto shpenzime nga cdo shume qe ajo i detyrohet tek Sipermarresit ose nga garancite qe ka ne dispozicion te saj.

### **RESPEKTIMI I INSTRUKSIONEVE DHE I URDHERAVE**

Sipermarresi eshte i detyruar te respektoje menjehere dhe plotesisht te gjithë urdherat dhe instruksionet e Mbikeqyresit ose te perfaqesuesve te tij dhe te Bankes.

Ne rast se ka kundershime per disa urdhera ose instruksione, ai eshte i detyruar ti respektoje plotesisht ato dhe njekohesisht, brenda 48 oresh, te paraqese kundershimet e tij. Kundershimet paraqiten tek Mbikeqyresi.



Paraqitja e kundershimit nuk e cliron Sipermarresin nga detyrimi per vazhdimin normal te punimeve.

### **DHENIA E TE DHENAVE**

Sipermarresi ose perfaqesuesi i tij jane te detyruar te dorezojne sa me shpejt te jete e mundur cdo te dhene qe mund te kerkohet nga Mbikqyresi ose nga perfaqesuesi i tij, ne lidhje me punimet e kryera si p.sh. te dhena teknike, etj. si dhe listen e personelit te punesuar.

Banka, nepermjet Mbikqyresit te saj, eshte gjithashtu e detyruar, qe t'i jape Sipermarresit ne kohen e duhur te dhena qe jane te domosdoshme per zbatimin e punimeve qe ai ka marre persiper. Ne qofte se ka vonesa ne dorezim, Sipermarresi ka te drejte t'i kerkoje ato me shkrim.

Pas perfundimit te punimeve, Sipermarresi eshte i detyruar, te dorezoje ne Banke nje vertetim per funksionimin e rregullt te kablllove te mbuluara.

### **PERSONELI I SIPERMARRESIT**

Sipermarresi, merr persiper shprehimisht detyrimin per te zene me pune punonjes dhe nepunes ekskluzivisht te siguruar prane sigurimeve shoqerore dhe shendetesore.

Sipermarresi deklaron se i gjithë personeli i tij qe do te punoje ne objekt eshte plotesisht i kualifikuar dhe ka eksperiencen perkatese dhe te nevojshme per punimet qe ai do te kryeje.

Personeli i Sipermarresit duhet te sillet ne menyre te kulturuar ne objekt, te mos shqetesoje personelin e Bankes dhe punonjesit e Sipermarresve te tjere qe mund te punojne ne objekt dhe te respektoje plotesisht urdherat dhe instruksionet e Mbikqyresit dhe te perfaqesuesve te tij.

Banka ka te drejte qe, sipas gjykimit te saj, te kerkoje largimin nga objekti te cdo pjestari te personelit te Sipermarresit dhe ky i fundit eshte i detyruar ta zevendesoje menjehere ate me nje punonjes tjetër

### **DETYRIMET NDAJ SIGURIMEVE SHOQERORE DHE SHENDETESORE**

Cdo lloj pagese ndaj organeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore, per te gjithë personelin qe punon ne objekt paguhet ekskluzivisht nga Sipermarresi.

Banka ka te drejte te kontrolloje, ne cdo kohe, shlyerjen e detyrimeve te Sipermarresit ndaj organeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore, dhe ky i fundit eshte i detyruar qe me kerkesen e pare te Bankes t'i dorezoje asaj menjehere vertetime per pagimin e detyrimeve kundrejt ketyre organeve.

E drejta e kontrollit nga Banka, ne asnje rast nuk e cliron Sipermarresin nga detyrimi per shlyerjen e ketyre detyrimeve ne kohen e duhur. Ne rast se Sipermarresi vonon te dorezoje vertetimet perkatese qe i jane kerkuar, Banka ka te drejte te refuzoje kryerjen e pagesave ndaj tij deri ne paraqitjen e vertetimeve perkatese.

Sipermarresi eshte i detyruar te dorezoje ne Banke, bashke me shpenzimet perfundimtare vertetimet e leshuara nga organet e sigurimeve shoqerore e shendetesore per shlyerjen e te gjithë detyrimeve te tij qe lidhen me kete kontrate sipermarrijeje. Ne rast se Sipermarresi nuk dorezon vertetimet e siperpermendura, Banka ka te drejte te refuzoje shlyerjen deri ne paraqitjen e vertetimeve perkatese.

### **KONTROLLI I ECURISE DHE CILESISE SE PUNIMEVE**

Sipermarresi garanton kryerjen e punimeve ne afat dhe ne perputhje me kushtet e kesaj kontrate dhe me rregullat teknike. Ne menyre te vecante, ai garanton se punimet do te kene karakteristikat qe percaktohen ne kushtet teknike dhe ne projektet e studimit dhe do te jene te arritura nga pikepamja e zbatimit dhe nuk do te kene te meta e mangesi qe rrjedhin nga perlllogaritja e gabuar, zbatimi i keq, jo cilesor dhe cilesia e materialeve te perdoruara.

Banka, nepermjet Mbikqyresit, ka te drejten absolute per te kontrolluar punimet nga pikepamja cilesore, zbatimin e sakte dhe te sigurt te ritmeve te ecurise, etj., dmth te te gjithë punimeve te cilat kryen Sipermarresi. Ne rast se gjate zbatimit te punimeve, personeli, makinerite, mjetet e punes jane te pamjaftueshme, nga pikepamja cilesore dhe sasiore, per zbatimin e punimeve brenda afatit te caktuar, ose shkaktojne zbatimin e punimeve me te meta dhe me mangesi, atehere Sipermarresi eshte i detyruar qe sipas instruksionit te Mbikqyresit ose te perfaqesuesit te tij, te korrigoje menjehere mangesite. Nderhyrja e mundeshme e Mbikqyresit ne ecurine e punimeve, ne asnje menyre nuk redukton pergjegjesine e Sipermarresit per perfundimin e punimeve ne afat, per te cilat ai eshte pergjegjesi i vetem dhe ekskluziv.

Sipermarresi, ne rastin e vonesave per faj te tij dhe kur i kerkohet nga Mbikqyresi, eshte i detyruar te perforcoje skuadren e punimeve duke organizuar punen edhe jashte orarit ose edhe me turn te trete, pa ndryshuar cmimin e tij dhe, pa patur te drejte te kerkoje demshperblim per rritjen e shpenzimeve te tij per shkaqet e mesiperme.



### **PUNIMET JASHTE NORMAVE TEKNIKE**

Pjeset e objektit ose pjeset e punimeve te cilat gjate fazes se zbatimit ose te dorezimit gjykohen nga Mbikeqyresi se nuk jane ne perputhje me kushtet e kesaj kontrate, me projektet, pershkrimin teknik, oferten dhe pergjithesisht me normat teknike, prishen dhe rindertohen nga Sipermarresi me shpenzimet e tij menjehere pas dhenies se urdherit perkates.

Ne rast se Sipermarresi kundershton ose nxjerr pengesa per zbatimin e instruksionit te mesiperme, Banka ka te drejte te zgjidhe menjehere kete kontrate nepermjet nje njoftimi me shkrim.

Materialet qe nuk u pergjigjen kushteve te kesaj kontrate duhet te largohen nga objekti brenda 2 (dy) diteve pas instruksionit perkates te Mbikeqyresit, perndryshe largimi i tyre behet nga vete Banka me shpenzime dhe per llogari te Sipermarresit, sipas neneve te mesiperme.

### **RESPEKTIMI I AUTORITETEVE POLICORE DHE I RENDIT PUBLIK**

Sipermarresi eshte i detyruar te respektojte plotesisht kushtet e sigurimit, te qetesise publike, te qarkullimit te automjeteve etj, edhe ne rast se masat qe mund te instruktojne ose te kerkojne autoritetet policore ose autoritetet e tjera, nuk jane percaktuar qartesisht nga perfaqesuesit e Bankes ose nuk eshte dhene urdher paraprak me shkrim per zbatimin e tyre.

Pergjegjesia e zbatimit te ketyre masave bie ekskluzivisht mbi Sipermarresin.

### **SIGURIMI I OBJEKTIT**

Sipermarresi eshte i detyruar te siguroje Banken se do kryeje pagesen ne rastin e cdo lloj rreziku per shendetin, integritetin apo demtimet materiale te punonjesve ne objekt, si dhe te tretet qe do te pesonin deme nga zbatimi i punimeve.

Sipermarresi, gjate gjithë kohes se punimeve, merr persiper detyrimin per te respektuar ligjet ne fuqi, aktet nenligjore dhe regulloret lidhur me sigurimin dhe shendetin e punonjesve dhe ne pergjithesi te te gjithë personelit qe punon ne objekt.

### **SHPERBLIMI PER PUNEN – STABILITETI I CMIMEVE**

Palet e kesaj kontrate, jane marre vesh qe ne cmimet per njesi (te rena dakord), sikurse jane percaktuar ne Aneksin A perfshihen te gjithë shperblimet e Sipermarresit, te cdo lloj natyre, qe jane te nevojshme per zbatimin e plote te punimeve ne perputhje me kushtet teknike dhe me kete kontrate, si edhe te cdo lloj punimi tjeter qe ka lidhje me keto.

Sipermarresi deklaron qe kontrata u hartua ne baze te preventivit, saktesia dhe mjaftueshmerine e te cilit garanton punimet, per kete arsye ai heq dore pa asnje rezerve nga cdo e drejte, qofte kjo edhe ne te ardhmen per te kerkuar shtese te shperblimit te sipermarrrjes te rene dakord.

Palet e kesaj kontrate bien dakord shprehimisht qe ne asnje rast nuk do te kete rishikim te cmimeve, qofte edhe ne rast te ndryshimit te kushteve te sotme ekonomike (te tregut), ose te shtesave te vleres se cdo materiali dhe shperblimeve per dite pune, si dhe te kontributeve per sigurimet shoqerore dhe shendetesore te personelit punonjes dhe teknik. Per kete qellim Sipermarresi deklaron pa asnje rezerve se ka marre ne konsiderate, me kujdes, cmimet e rena dakord, ne te cilat eshte perfshire edhe nje perqindje qe do ta mbuloje ate nga cdo lloj risku, rivleresimi, kostoje te paparashikuar ose ndonje arsye tjeter.

### **PAGESAT – ZBRITJE NGA PAGESAT (NDALESAT)**

Cdo lloj pagese e Sipermarresit kryhet sipas percaktimeve ne Aneksin A, ku perfshihet TVSH, bazuar ne situacionet qe miraton Mbikeqyresi.

Nga cdo faturim do te mbahen nga Banka perqindjet qe percaktohen nga kushtet e kesaj Kontrate, si garanci per zbatimin e Kontrates.

Gjithashtu, Banka ka te drejte te mbaje nga shumat qe duhet t'i paguaje Sipermarresit, cdo shume per llogari te gjobave qe mund ti jene faturuar Bankes nga organet kopetente, per mos respektim te Legjislacionit nga Sipermarresi.

Banka detyrohet te shlyeje Sipermarresin, brenda nje afati 30 ditor nga dorezimi i fatures (situacionit), nga Sipermarresi tek Banka dhe e konfirmuar nga perfaqesuesi i Bankes. Faturat (situacionet) duhet te shoqerohen nga dokumente justifikuese (evidenca krahasuese, matje etj).

Pagesa nga Banka e Sipermarresit do te kryhet kundrejt paraqitjes nga Sipermarresi te faturave me TVSH si dhe te situacioneve perkates.

Per cdo dite vonese ne pagese, "Banka" penalizohet sipas kamates ligjore ne fuqi, ne perputhje me Ligjin 48/2014



date 24.04.2014.

### **MARRJA NE DOREZIM E PUNIMEVE**

Pas perfundimit te punimeve, Mbikqyresi kontrollon cilesine e punimeve. Sipermarresi eshte pergjegjes per cdo te mete teknike qe do te verehet nga Mbikqyresi dhe eshte i detyruar, pa ndonje shperblim te vecante, ta rregulloje ate (d.m.th ta rindertoje ose zevendesoj) duke rregulluar te gjitha mangesite e verejtura nga Mbikqyresi brenda 48 oreve.

Nese pas perfundimit te afatit te permendur me lart, Banka konstaton se:

- a- sherbimi i kryer nga Sipermarresi nuk eshte ne cilesine e kerkuar, ose vjen ne kundertshtim me kushtet e kesaj kontrate, Banka ka te drejte te zgjidhe menjehere kete kontrate nepermjet nje njoftimi me shkrim. Banka do ti paguaj Sipermarresit detyrimet per punen e kryer sipas cmimit te percaktuar ne Ankesin A
- b- sherbimi i kryer nga Sipermarresi eshte ne cilesine e kerkuar dhe ne peputhje me kushtet e kesaj kontrate, kryhet marrja ne dorezim e punimeve dhe hartohet Protokolli i Marrjes ne dorezim nga te dy palet.

### **KALIMI I KONTRATES**

Sipermarresit eshte i ndaluar dhe shkarkohet menjehere nga detyra, ne rast kalimi te kesaj kontrate, direkt ose indirekt, pjeserisht ose teresisht, tek persona te trete.

### **VENDQENDRIMI I SIPERMARRESIT – NJOFTIMET**

Ne rast se Sipermarresi, mungon ose kundeshton marrjen ne dorezim te dokumentave apo njoftimeve, atehere ato do te dergohen me poste rekomande ne adresen e regjistruar te selise te tij.

Ne rast se Sipermarresi do te ndryshoje seline eshte i detyruar t'i njoftoje me shkrim menjehere Bankes adresen e re te tij, sepse ne te kundert do te konsiderohet i ligjshem njoftimi qe do te kryhet ne adresen e deklaruar fillimisht.

### **RUAJTJA E PUNIMEVE. SIGURIMI I MATERIALEVE.**

Sipermarresi ka pergjegjesine e ruajtjes se punimeve qe zbaton, te materialeve qe i ka dhene Banka, si edhe te materialeve dhe pajisjeve qe ka cuar ne objekt, gjate gjithë periudhes, nga dita e vendosjes ne objekt, deri ne dorezimin e punimeve. Gjate kesaj periudhe Banka nuk ka asnje pergjegjesi per humbjet apo demtimet e materialeve dhe pajisjeve, si edhe per demtimet qe mund t'i behen punimeve te kryera nga Sipermarresi.

### **PEZULLIMI I PUNIMEVE**

Ne rast pezullimi te punimeve, si rezultat i urdherit te autoriteteve, per shkak te grevave te pergjithshme ose forces madhore, Sipermarresi nuk ka te drejte per asnje lloj shperblimi per kete periudhe, pervec te drejtes qe ka per te shtyre afatin e punimeve per nje periudhe kohore te njejte me ate te pezullimit per arsyt e mesiperme.

Ne rast se Sipermarresi, nderpret aktivitetin e tij tregtar apo falimenton ose likujdohet, kontrata zgjidhet automatikisht. Kur, nderprerja e aktivitetit tregtar, likujdimi apo falimentimi i Sipermarresit, ndodh perpara nenshkrimet te kesaj kontrate dhe perpara vendosjes se tij ne objekt, kontrata zgjidhet automatikisht dhe garancia kthehet mbrapsht.

### **PASOJAT E MOSRESPEKTIMIT (MOSPERMBUSHJES) TE KUSHTEVE TE KONTRATES**

Per cdo shkelje nga ana e Sipermarresit te kushteve te kesaj kontrate, ose kushteve dhe marreveshjeve te bashkengjitura kesaj kontrate, i jep te drejte Bankes ta shpalle ate te deshtuar, me deklarim te thjeshte nga ana e saj. E njejta gje ka vlere edhe ne rastin e lenies pergjysem ose totalisht te punimeve, ne rastin e pakesimit te numrit te personelit te tij si edhe ne rastin e vonesave ne ecurine e punimeve, sipas gjykimit te Bankes.

Me deklarimin e Sipermarresit si te deshtuar, kalojne ne favor te Bankes, ne forme gjobe, cdo lloj shume qe i eshte mbajtur Sipermarresit nga situacionet si dhe garancia per cilesine e punimeve. Gjithashtu, Banka ka te drejte te kerkoje demshperblim per cdo humbje direkte ose indirekte qe eshte rezultat i shkeljes se kontrates, mospermbushja e kushteve te saj, apo anekseve te bashkengjitura asaj. Pas shpalljes se deshtimit, Banka ka te drejte te zbatoje punimet me Sipermarres te ri.

Ne nje rast te tille, Banka ka te drejte te urdheroje Sipermarresin qe te largoje nga objekti, brenda nje afati te caktuar, te gjithë materialet dhe pajisjet e tij. Sipermarresi detyrohet te zbatoje kete kusht, perndryshe i jep Bankes qe tani, urdhrin e parevokueshem, qe ajo ka te drejte qe t'i largoje ato me shpenzimet e Sipermarresit dhe pa detyrimin per ruajtjen e tyre pas largimit.

### **RUAJTJA E SEKRETIT**

Sipermarresi dhe punonjesit e saj jane kategorikisht te ndaluar te kene akses ne te dhenat personale te te treteve





te mbledhura nga "Banka" gjate aktivitetit te saj.

Palet jane te detyruara te ruajne plotesisht konfidencialitetin dhe te mos u bejne te njohur te treteve asnje informacion qe ato mund te marrin, si gjate zbatimit te kesaj kontrate ashtu edhe pas perfundimit te saj.

Palet bien dakord qe konsiderohen te fshehta dhe sekrete informacionet me goje ose me shkrim, te dhenat, metodat, teknikat ose procedurat qe ndjek Banka per planifikimin, zhvillimin dhe ofrimin e produkteve ose sherbimeve te saj si dhe cdo informacion qe ka te beje me strukturen materialoteknike, ambientet dhe instalimet qe gjenden ne te, per klientelen, veprimtarine afariste dhe personelit qe ka Banka

Sipermarresi si dhe punonjesit e tij, jane te detyruar per mbajtjen e fshehtesise se plote per informacionet dhe te dhenat qe behen te njohura per ta nepermjet kesaj kontrate, duke pasur pergjegjesi penale ne baze te Kodit Penal si dhe pergjegjesi per kompensimin e cdo demi qe mund ti shkaktohet Bankes per arsye te shkeljes se detyrimit te lartpermendur.

Sipermarresi duhet te njoftoje Banken ne rast cenimi te te dhenave personale te mbledhura nga kjo e fundit.

Sipermarresi duhet te njoftoje Banken menjehere dhe pa vonese, per cdo dem, demtim ose per cdo ngjarje tjeter te jashtezakonshme gjate ushtrimit te sherbimit.

### **ANKIMIMET**

Objekt ankimimi do te jete mosrealizimi i neneve te kesaj kontrate.

Ankimimet do te behen nga Banka me shkrim brenda 5 (pese) diteve nga data e konstatimit ose perfundimit te afatit te sherbimit.

Sipermarresi brenda 48 oreve nga marrja e njoftimit per ankim ndaj sherbimit, duhet te paraqitet prane Bankes, per te zgjidhur objektin e Ankimimit ne te kundert do te aplikohet si me lart.

### **TERHEQJA NGA KONTRATA**

Secila pale mund te terhiqet nga kontrata, ne qofte se pala tjeter shkakton shkelje themelore te saj qe jane:

a. Banka konstaton se:

- Sipermarresi nuk ploteson kerkesat cilesore te sherbimit.
- Sipermarresi vonon sherbimin, tej afateve te percaktuara ne kontrate.
- Sipermarresi nuk eshte ne gjendje te permbushje ne rregull, detyrimet kontraktore.

Ne rast se kontrata zgjidhet nga "Banka" per shkaqet e permendura ne germen a te kesaj pike, "Sipermarresi" eshte i detyruara t'i paguaj "Bankes" nje penalitet ne masen prej 5 % te vleres se shlyer te kontrates.

b. Sipermarresi mund te terhiqet nga kontrata kur Banka nuk kryen ne afat, pagesat per sherbimin e ofruar dhe te marre ne dorezim prej tij, edhe kur cilesia e ketij te sherbimi ka qene ne perputhje te plote me kushtet e percaktuara ne dokumentat e kerkuara. Ne nje rast te tille Sipermarresi i dergon njoftim me shkrim Bankes per pagesen e fatures. Nese Banka nuk kryen pagesen brenda 5 diteve pune nga dita qe ka marre njoftimin, Sipermarresit i lind e drejta te nderprese menjehere nepermjet nje njoftimi me shkrim kete kontrate.

c. Secila pale mund te kerkoje ne cdo kohe, zgjidhjen e kesaj kontrate, duke e lajmeruar me shkrim palen tjeter 60 dite kalendarike me perpara.

### **KLAUZOLA KUNDER RYSHFETIT DHE KORRUPSIONIT**

Sipermarresi angazhohet se nuk do te marre, nuk do te ofroje, premtaje ose do te jape ndonje perfitim financiar ose te ndonje lloji tjeter, qe nuk eshte i detyrueshem sipas praktikave me te mira tregtare apo kushteve kontraktuale, drejtperdrejt ose terthorazi per ndonje person ose subjekt te lidhur apo jo me Banken, ne kembim qe ata te veprojne ose te mos veprojne ne kundershtim me permbushjen e detyrave te tyre per t'i mundesuar Sipermarresit lidhjen dhe/ose permbushjen e kesaj Kontrate.

### **FORCAT MADHORE**

Palet bien dakort se asnje pale nuk do te jete pergjegjese ne mospermbushje te detyrimeve ndaj pales tjeter nese keto vijne si rezultat i Forcave madhore, sic jane embargo, revolucion, greve, lufte (te deklaruar ose jo), aksione apo kercenime nga terroristet ose grupet guerrile, zjarri, permbytjet, termetet.

**10. Per informacione te metejshme ju mund te kontaktoni me:**

***E-mail. [procurement@tiranabank.al](mailto:procurement@tiranabank.al)***



11. Ju lutem konfirmoni ne e-mailin e sipershenuar marrjen e kesaj ftese dhe nese ju pranoi te merrin pjese ne kete procedure prokurimi.
  
12. **Ne vemendjen tuaj:** Pagesat per kompanine/te fituese per procesin e prokurimit do te behen nepermjet llogarise ne Banken Tirana dhe ne rast se nuk ka mundesi per te hapur nje llogari ne Banken Tirana, komisionet e transferimit do t'i ngarkohen kompanise.

Sinqerisht,  
**BANKA TIRANA**



## ANEKSI A - OFERTA FINANCIARE

NDERTIM					
Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
<b>A. PUNIME NDËRTIMI</b>					
<b>1. PUNIME GIPSI</b>					
1	FV mure gipsi për ndarjet e brendëshme t=10 cm tip T1 sipas VT	m <sup>2</sup>	565.00		
2	FV mure gipsi për ndarjet e brendëshme t=15 cm tip T2 sipas VT	m <sup>2</sup>	350.00		
3	FV mure gipsi të harkuar për ndarjet e brendëshme t=15 cm tip T3 sipas VT	m <sup>2</sup>	1,072.00		
4	FV tavan i varur me gips të thjeshtë T1	m <sup>2</sup>	3,140.00		
5	FV tavan i varur me gips kundër lagështirës T2	m <sup>2</sup>	165.00		
<b>Shuma 1</b>					
<b>2. PUNIME PATINIMI DHE VESHJE</b>					
1	FV patinim mure dhe tavane gipsi	m <sup>2</sup>	6,177.00		
2	FV veshje me panel multistrad e mureve te hakuar	m <sup>2</sup>	1,072.00		
<b>Shuma 2</b>					
<b>3. PUNIME BOJATISJE</b>					
1	FV lyerje te brendshme mure+tavane	m <sup>2</sup>	6,177.00		
<b>Shuma 3</b>					
<b>4. DYER</b>					
2	FV dyer filomuro D3 me permasa 220x98 cm	Copë	12.00		
3	FV dyer filomuro D7 me permasa 220x100 cm	Copë	1.00		
4	FV dyer MDF D4 permasa 220x78 cm	Copë	23.00		
5	FV dyer MDF D5 permasa 220x88 cm	Copë	5.00		
6	FV dyer MDF D6 permasa 220x88 cm	Copë	6.00		
<b>Shuma 4</b>					
<b>TOTALI NDERTIM pa TVSH (Shuma 1÷4)</b>					
<b>TVSH</b>					
<b>TOTALI me TVSH NDERTIM</b>					
<b>RIFINITURAT</b>					
Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
<b>A. PUNIME NDERTIMI</b>					
1	FV shtrim me pllaka	m <sup>2</sup>	137.00		
<b>Shuma 1</b>					
<b>2. PUNIME MURATURE</b>					
1	F.V. mur me tulla te plota t=25 cm	m <sup>3</sup>	26.93		
2	F.V. hekur per brezat	kg	523.81		
3	FV breza ne murature tulle	m <sup>3</sup>	4.35		
<b>Shuma 2</b>					
<b>3. PUNIME GIPSI</b>					
1	FV ndertim mur gipsi kunder zjarrit sipas st	m <sup>2</sup>	89.24		
2	FV perforcim me profil UA perfshire kit fiksimi	ml	4.80		
3	FV ndertim tavan gipsi i drejte me pllake kundra zjarrit sipas st	m <sup>2</sup>	137.00		
<b>Shuma 3</b>					
<b>4. PUNIME VESHJE</b>					
1	FV suvatim mur tulle	m <sup>2</sup>	287.50		
2	FV patinim mure + tavane gipsi	m <sup>2</sup>	279.97		
<b>Shuma 4</b>					
<b>5. PUNIME BOJATISJE</b>					
1	FV lyerje me boje mure+tavane	m <sup>2</sup>	567.47		



	<b>Shuma 5</b>								
	<b>6. DYER</b>								
1	FV dere antizjarr sipas ST	cope	5.00						
	<b>Shuma 6</b>								
	<b>Shuma 1 (1÷6)</b>								
	<b>2.ARKIVA</b>								
	<b>1. PUNIME SHITESASH</b>								
1	FV shtrim me pllaka	m <sup>2</sup>	204.00						
	<b>Shuma 1</b>								
	<b>2. PUNIME MURATURE</b>								
1	F.V. mur me tulla te plota t=25 cm	m <sup>3</sup>	38.95						
2	F.V. hekur per brezat	kg	744.92						
3	FV breza ne murature tulle	m <sup>3</sup>	6.30						
	<b>Shuma 2</b>								
	<b>3. PUNIME GIPSI</b>								
1	FV ndertim mur gipsi kunder zjarrit	m <sup>2</sup>	325.96						
2	FV perforcim me profil UA perfshire kit fiksimi	ml	17.00						
3	FV ndertim tavan gipsi i drejte me pllake kundra zjarrit	m <sup>2</sup>	204.00						
	<b>Shuma 3</b>								
	<b>4. PUNIME VESHJE</b>								
1	FV suvatim mur tulle	m <sup>2</sup>	287.50						
2	FV patinim mure + tavane gipsi	m <sup>2</sup>	707.30						
	<b>Shuma 4</b>								
	<b>5.PUNIME BOJATISJE</b>								
1	FV lyerje me boje te bardhe mure+tavane	m <sup>2</sup>	994.80						
	<b>Shuma 5</b>								
	<b>6. DYER</b>								
1	FV dere antizjarr sipas ST	cope	17.00						
	<b>Shuma 6</b>								
	<b>Shuma 2 (1÷6)</b>								
	<b>Totali Rifiniturat pa TVSH (Shuma 1+ Shuma 2)</b>								
	<b>TVSH</b>								
	<b>Totali me TVSH - Rifiniturat</b>								
<b>ELEKTRIKE</b>									
<b>PREVENTIV PUNIMESH ELEKTRIKE HO-s TIRANA BANK TEK MET BUILDING</b>									
Nr	Përshkrimi i zëri të punës	Njësia	Sasia	Çmimi / Njësi	Vlera				
<b>ZYRAT HO-s Katet +1, +2, +5</b>									
<b>A</b>	<b>Sistemi i Fuqise</b>								
A.01	F.V. Panel elektrik sipas Skemes se projektit KTB Kati 1	Copë	1						
A.02	F.V. Panel elektrik sipas Skemes se projektit KTB Kati 2	Copë	1						
A.03	F.V. Panel elektrik sipas Skemes se projektit KTB Kati 5	Copë	1						
A.06	F.V. Kuti 4 module gipsi e kompletuar me te gjithë aksesoret e montimit si vida upa etje	Copë	22						
A.07	F.V. Suport + kapak 4 modul seria e thjesht e bardhe e kompletuar me te gjithë aksesoret e montimit si vida upa etj	Copë	22						
A.08	F.V. Kuti 3 module gipsi e kompletuar me te gjithë aksesoret e montimit si vida upa etje	Copë	5						
A.09	F.V. Suport + kapak 3 modul seria e thjesht e bardhe	Copë	13						
A.10	F.V. Prize shuko 16 A te kuqe	Copë	1,149						



A.11	F.V. Kanaline metalike tip grile 200x75 mm e kompletuar me te gjithë aksesoret e montimit si suportet per tu mbeshtetur etj	ml	400		
A.12	F.V. Kanaline metalike tip grile 150x75 mm e kompletuar me te gjithë aksesoret e montimit si suportet per tu mbeshtetur etj	ml	400		
A.13	F.V. Kanaline metalike e brimezuar 150x75 mm e kompletuar me te gjithë aksesoret si kthesa, nderrime plani etj	ml	400		
A.14	F.V. Tub fleksibel Ø=20 mm seria e rende i kompletuar me te gjithë aksesoret per fiksime ne tavan dhe ne faqe gipsi, si fasheta, grapeta vida upa fi 6mm	ml	1,700		
A.15	F.V. Tub fleksibel Ø=25 mm seria e rende i kompletuar me te gjithë aksesoret per fiksime ne tavan dhe ne faqe gipsi, si fasheta, grapeta vida upa fi 6mm	ml	3,100		
A.16	F.V. Kabell FROR 3x2.5 mm2	ml	4,900		
A.17	F.V. Kabell FG16OR16 4x95 +1x50 mm2 0.6/1kV	ml	60		
A.18	F.V. Kabell FG16OR16 5x2.5 mm2 0.6/1kV	ml	20		
A.19	F.V. Kabell FG16OR16 5x6 mm2 0.6/1kV	ml	30		
A.20	F.V. Kabell FG16OR16 5x16 mm2 0.6/1kV	ml	20		
A.21	F.V. Kabell sinjali 12x1.5 mm2 0.6/1kV	ml	30		
A.22	F.V. Kuti ne kanaline metalike 100x100 e kompletuar me te gjithë aksesoret e montimit si vida upa etje	Copë	415		
A.23	F.V. Torrete 12Module	Copë	73		
A.24	F.V. Torrete 24Module	Copë	128		
A.25	F.V. Torrete 6Module	Copë	54		
A.26	F.V. Lidhja me blindozbarre me konektor, kabell, te gjithë aksesoret dhe pune e perfunduar, duke ju referuar automatit kryesor 4P 160A, kati +2	Copë	1		
A.27	F.V. Lidhja me blindozbarre me konektor, kabell, te gjithë aksesoret dhe pune e perfunduar, duke ju referuar automatit kryesor 4P 125A, kati +1	Copë	1		
A.28	F.V. Lidhja me blindozbarre me konektor, kabell, te gjithë aksesoret dhe pune e perfunduar, duke ju referuar automatit kryesor 4P 20A, kati +5	Copë	1		
<b>C</b>	<b>Sistemi Data/Tel/HDMI</b>				
C.01	F.V. HP 42U Networking Rack Cabinet 80x120 Cm perfshire terminimin e kabllave ne patch panele, I gjithë rrjeti Data (prize, kabell, patch panel, Rack) duhet te jete i tokezuar, etiketimi/emërtimin, testim kolaudim.	set	4		
C.02	F.V. HP Networking Rack 28U 80x60 Cm perfshire terminimin e kabllave ne patch panele, I gjithë rrjeti Data (prize, kabell, patch panel, Rack) duhet te jete i tokezuar, etiketimi/emërtimin, testim kolaudim.	set	2		
C.03	F.V. Patch panel FTP Cat 6, 48 porta duke perfshire dhe terminimin dhe emertimine kabujve FTP Cat 6, I gjithë rrjeti Data (prize, kabell, patch panel, Rack) duhet te jete i tokezuar.	Copë	16		
C.04	Patch pannel bashkëpunimi me 24 porte, I gjithë rrjeti Data (prize, kabell, patch panel, Rack) duhet te jete i tokezuar.	Copë	5		
C.05	F.V. Patch Guide per 48 porta, I gjithë rrjeti Data (prize, kabell, patch panel, Rack) duhet te jete i tokezuar.	Copë	16		
C.06	F.V. Rack 6U 60x45 Cm perfshire terminimin e kabllave ne patch panele, testim kolaudim., I gjithë rrjeti Data (prize, kabell, patch panel, Rack) duhet te jete i tokezuar.	set	1		
C.07	F.V. Patch panel FTP Cat 6, 24 porta duke perfshire dhe terminimin dhe emertimine kabujve FTP Cat 6, I gjithë rrjeti Data (prize, kabell, patch panel, Rack) duhet te jete i tokezuar.	Copë	1		
C.08	F.V. Patch Guide per 24 porta	Copë	1		
C.09	F.V. Power bar 6 - 8 shuko	Copë	5		
C.10	F.V. Bateri ventilatoresh te kopletuar me te gjithë aksesoret si permostat, kontrollor temperature etje	Copë	5		
C.11	F.V. Kabuj LAN RJ45 Cat6 SFTP, nga Kati 1 (patch paneli 1) në Katin 2.	Copë	24		
C.12	F.V. Kabuj LAN RJ45 Cat6 SFTP, nga Kati 1 (patch paneli 2) në Katin 5.	Copë	12		



C.13	F.V. Kabull LAN RJ45 Cat6 SFTP, nga Kati 1 (patch paneli 2) në Katin 0(Dega Premium).	Copë	12		
C.14	F.V. Kabuj LAN RJ45 Cat6 SFTP (nga patch paneli i planifikuar për rrjetin e HO, pa lidhje me patch panelin e bashkëpunimit), nga Kati 1 në Katin -1.	Copë	4		
C.15	F.V. Kabell FTP Cat 6	ml	29,000		
C.16	F.V. Priza FTP CAT 6 RJ 45, I gjithë rrjeti Data (prize, kabell, patch panel, Rack) duhet te jete i tokezuar.	Copë	742		
C.17	F.V. Priza HDMI	Copë	54		
C.18	F.V. Kabell HDMI	ml	100		
C.19	F.V. Tub fleksibel Ø=32 mm seria e rende i kompletuar me te gjithë aksesoret per fiksime ne tavan dhe ne faqe gipsi, si fasheta, grapeta vida upa fi 6mm	Copë	100		
<b>Shuma 1 ZYRAT HO-s Katet +1, +2, +5 PA TVSH</b>					
<b>ARKIVA DHE MAGAZINA HO-s Kati -1</b>					
<b>A</b>	<b>Sistemi i Fuqise</b>				
A.01	F.V. Panel elektrik sipas Skemes se projektit KAM	Copë	1		
A.03	F.V. Kuti 4 module gipsi e kompletuar me te gjithë aksesoret e montimit si vida upa etje	Copë	1		
A.04	F.V. Suport + kapak 4 modul seria e thjesht e bardhe e kompletuar me te gjithë aksesoret e montimit si vida upa etj	Copë	1		
A.05	F.V. Kuti 3 module gipsi e kompletuar me te gjithë aksesoret e montimit si vida upa etje	Copë	43		
A.06	F.V. Suport + kapak 3 modul seria e thjesht e bardhe	Copë	43		
A.07	F.V. Prize shuko 16 A te bardha	Copë	18		
A.08	F.V. Prize shuko 16 A te kuqe	Copë	2		
A.09	F.V. Kanaline metalike e brimezuar 100x75 mm e kompletuar me te gjithë aksesoret si kthesa, nderrime plani etj	ml	40		
A.10	F.V. Tub fleksibel Ø=20 mm seria e rende i kompletuar me te gjithë aksesoret per fiksime ne tavan dhe ne faqe gipsi, si fasheta, grapeta vida upa fi 6mm	ml	100		
A.11	F.V. Tub fleksibel Ø=25 mm seria e rende i kompletuar me te gjithë aksesoret per fiksime ne tavan dhe ne faqe gipsi, si fasheta, grapeta vida upa fi 6mm	ml	50		
A.12	F.V Tub i ngurte PVC,djegje pa flake dhe pa emetim gazi, Ø20mm me te gjithë aksesore lidhes ndermjet tyre ( si bashkues, bryla 90 grade, ti etje )si dhe aksesoret per montim si grapeta, vida upa Ø6mm etje pune e perfunduar	ml	100.00		
A.13	F.V Tub i ngurte PVC,djegje pa flake dhe emetim gazi, Ø25mm me te gjithë aksesore lidhes ndermjet tyre ( si bashkues, bryla 90 grade, ti etje )si dhe aksesoret per montim si grapeta, vida upa Ø6mm etje pune e perfunduar	ml	50.00		
A.14	F.V. Kabell FG16OR16 3x2.5 mm2	ml	25		
A.15	F.V. Percjelles 3x1x2.5 mm2	ml	50		
A.16	F.V. Kuti ne kanaline metalike 100x100 e kompletuar me te gjithë aksesoret e montimit si vida upa etje	Copë	9		
A.17	F.V. Kuti shperndarese brenda murit e kompletuar me te gjithë aksesoret e montimit si vida upa etj	Copë	5		
A.18	F.V. Kuti shperndarese jashte murit	Copë	4		
A.19	F.V. Lidhja me blindozbarre me konektor, kabell, te gjithë aksesoret dhe pune e perfunduar, duke ju referuar automatit kryesor 4P 16A, Arkiva-Magazina	Copë	1		
<b>C</b>	<b>Sistemi Data/Tel/HDMI</b>				
C.01	F.V. Rack 6U 60x45 Cm perfshire terminimin e kablllove ne patch panele, i gjithë rrjeti Data (prize, kabell, patch panel, Rack) duhet te jete i tokezuar. testim kolaudim.	set	1		
C.02	F.V. Patch panel FTP Cat 6, 24 porta duke perfshire dhe terminin dhe emertimine kabujve FTP Cat 6, I gjithë rrjeti Data (prize, kabell, patch panel, Rack) duhet te jete i tokezuar.	Copë	1		



C.04	F.V. Patch Guide per 24 porta	Copë	1		
C.05	F.V. Power bar 6 - 8 shuko	Copë	5		
C.06	F.V. Bateri ventilatoresh te kopletuar me te gjithë aksesoret si permostat, kontrollor temperature etje	Copë	5		
C.07	F.V. Kabell FTP Cat 6	ml	15		
C.08	F.V. Priza FTP CAT 6 RJ 45, I gjithë rrjeti Data (prize, kabell, patch panel, Rack) duhet te jete i tokezuar.	Copë	2		
<b>Shuma 2 (ARKIVA DHE MAGAZINA Kati -1) pa TVSH</b>					
<b>Total pa TVSH Elektrike (Shuma 1+ Shuma 2)</b>					
<b>TVSH</b>					
<b>Totali me TVSH - Elektrike</b>					
<b>Vlera totale Preventiv punime ndertimi me TVSH</b>					
<b>Vlera totale Preventiv rifiniture me TVSH</b>					
<b>Vlera totale Preventiv Elektriket me TVSH</b>					
<b>T O T A L I me TVSH</b>					

**Çmimet duhet te perfshijne TVSH-ne si dhe te gjitha taksat ose shpenzimet e nevojshme. Oferta juaj financiare duhet te jete ekzaktesisht sipas tabelës së mesiperme.**

**Afati i levrimit:**

- Procesi i realizimit te punimeve te projektit fillestar (blerje, prodhim dhe implementim) duhet te finalizohet brenda dates 30.04.2025. **Konfirmimin tuaj:** \_\_\_\_\_.
- Nga ju duhet te dergohet skeduli i punimeve qe do te kryhen brenda dates 30.04.2025.

**Garancia:**

- Garanci materialesh elektrike – Kerkuar nga Banka minimumi 1 vit. **Ofruar nga ju:** \_\_\_\_\_
- Garanci punimesh elektrike – Kerkuar nga Banka minimumi 1 vit. **Ofruar nga ju:** \_\_\_\_\_

**Klientet:**

**Klientet per punime te njejta apo te ngjashme me ate te kerkuar:** \_\_\_\_\_

